



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

Nr. 646/2 prot

Datë 18.03.2024

**FORMULAR PËR PUBLIKIM**  
**LIDHUR ME ARSYET E SKUALIFIKIMIT NË RASTIN E ANKESAVE PËR**  
**VENDIMIN E VLERËSIMIT/KLASIFIKIMIT PËRFUNDIMTAR**

- Objekt:** Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Tenuis Laboratories” SHPK në procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur, e thjeshtuar*”, me Nr.REF-94828-02-08-2024, me objekt “*Monitorimi i Parametrave Mjedisore dhe Hartimi i Raporteve Mjedisore per Landfillin*”, me fond limit 3,000,000 lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 20.02.2024, nga autoriteti kontraktor, ECO-ELB SHA.
- Ankimues:** Operatori ekonomik “Tenuis Laboratories” SHPK me NIPT (L81904506I), me adresë: Rruga dytësore “Maminas – Vorë”, Nr. 20/38, Koxhas, Durrës
- Autoriteti Kontraktor:** ECO-ELB SHA, me adresë: Lagja “Brigada 17 Sulmuese”, Bulevardi “Qemal Stafa”, Elbasan

Në datën 13.03.2024 pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankimi elektronik me nr. aplikimi të ankesës online A/2024/3901 datë 13.03.2024 dhe me nr. protokolli 646/2024, e operatorit ekonomik “Tenuis Laboratories” SHPK për procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur, e thjeshtuar*”, me Nr.REF-94828-02-08-2024, me objekt “*Monitorimi i Parametrave Mjedisore dhe Hartimi i Raporteve Mjedisore per Landfillin*”, me fond limit 3,000,000 lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 20.02.2024, nga autoriteti kontraktor, ECO-ELB SHA.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “Tenuis Laboratories” SHPK, në procedurën e mësipërme të prokurimit.

Bazuar në nenin 112, pika 4, gërma “b” të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet se: “Në mënyrë që ankesa të bëhet e aksesueshme jo vetëm nga autoriteti ose enti kontraktor, por njëkohësisht edhe nga operatorët ekonomikë të interesuar, KPP-ja publikon:  
b) arsyet e skualifikimit në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar;”.

Komisioni i Prokurimit Publik do të publikojë arsyet e skualifikimit që operatori ekonomik “Tenuis Laboratories” SHPK kundërshton me anë të ankimit elektronik nr. A/2024/3901 datë 13.03.2024 dhe me nr. protokollin 646/2024. Konkretisht për arsyet e skualifikimit si më poshtë:

*“OPERATORI “Tenuis Laboratories”*

*Operatori ekonomik “Tenuis Laboratories” nuk përmbush pikën 2.3.5 të DST*

*2.3.5 Operatori Ekonomik, duhet të vërtetojë se mund të sigurojë të paktën 1 (një) pajisje laboratorike, për të bërë të mundur matjen e cdo parametri të listuar. OE duhet të paraqesë një deklaratë, ku për çdo parametër të listuar në shtojcën Nr.5 të vërtetojë se disponon një pajisje laboratorike dhe të shpjegojë se si do të realizohet matja e secilit parametër.*

*\* Faturën e blerjes (në rast pronësie) ose*

*\* Kontratën e qirasë (në rastin e marrjes me qira).*

*OE “Tenuis Laboratories” në dokumentat e ngarkuara në sistem ka paraqitur një deklaratë në të cilën deklaron se përmbush të gjitha kërkesat dhe specifikimet për kryerjen e shërbimit për cdo parametër të analizave Kimiko-Fizike, sipas shtojcës Nr 5 të Dst, por nuk ka listuar pajisjet laboratorike dhe shpjegimet përkatëse se si do të realizohet matja e secilit prej parametrave të listuar në shtojcën nr. 5 të Dst.*

*Në LPP nr. 162, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik", neni 92, pika 3, parashikohet se: 3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji.*

*Sa mesiper, operatori “Tenuis Laboratories” sh.p.k. nuk kualifikohet.”*

Publikuar në regjistrin e ankesave më datë 18.03.2024.

## **KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**Anëtar**  
**Kreshnik Ternova**

**Anëtar**  
**Anila Malaj**

**Kryetar**  
**Jonaid Myzyri**